



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-  
KOMISIONI I KONKURENCES**

---

**Njoftim për shtyp**

**Mbi**

**Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Deutsche Telekom AG në shoqërinë Hellenic Telecommunication Organization SA dhe indirekt në shoqërinë AMC SHA**

Komisioni i Konkurrencës në mbledhjen e datës 22.09.2008 miratoi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm në shoqërinë Hellenic Telecommunication Organization SA (OTE) nga shoqëria Deutsche Telekom. Me anë të kësaj kontrate, transaksioni paraqitet si përfutim kontrolli i drejtëpërdrejtë i DT në O.T.E. Ndërkohë kjo kompani fiton kontroll të tërthortë mbi shoqërinë e telefonisë së lëvizshme, Albanian Mobile Communication (AMC ShA), ku OTE zotëron 82% të aksioneve nëpërmjet Cosmote Group.

Me realizimin e këtij transaksioni, DT synon të zgjerojë tregun e komunikimit të telefonisë, kryesisht të telefonisë së lëvizshme; të rrisë shërbimet e internetit në telefoninë e lëvizshme etj. Në këtë mënyrë pritet që të përmirësojë konkurrueshmëria në tregun kombëtar.

OTE është e pranishme në tregun e brendshëm, indirekt, për shërbimet e telefonisë së lëvizshme, nëpërmjet kontrollit të filialit kryesor Cosmote, tek shoqëria AMC ShA.

Transaksioni i synuar prek industrinë e telekomunikacionit, por realizimi i tij, nuk sjell mbivendosje të shërbimeve fikse apo të lëvizshme, mbasi palët pjesëmarrëse nuk kanë pjesëmarrje të kryqëzuar në tregjet gjeografik edhe për sa i përket kontrollit në filialet e tyre apo në shoqëri të tjera dhe nuk kanë klientë të përbashkët, pra nuk shkakton kufizim të konkurrencës.

Transaksioni që realizon përfutimin e kontrollit influencues të operatorit strategjik DT në OTE, nëpërmjet ndryshimit të politikës së drejtimit, zhvillimit të teknologjisë dhe inovacioneve, pritet të rrisë konkurrueshmërinë në tregun e telefonisë në përgjithësi dhe indirekt në veçanti, edhe në Shqipëri për telefoninë e lëvizshme.

Për këto arsye, në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" i ndryshuar, **vendosi të autorizojë** përqëndrimin e realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të vetëm nga shoqëria Deutsche Telekom direkt në shoqërinë OTE në Greqi dhe indirekt në AMC ShA në Shqipëri nëpërmjet përfitimit të kontrollit të 82 % të aksioneve.

---

[www.caa.gov.al](http://www.caa.gov.al)  
[competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al)  
tel: +355 4 2234504  
fax: 355 4 2234497